



BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin po kërkon të punësoj një Financier/e projekti

Bashkia Peqin në kuadër të projektit Mind the Gap- A model or Social Inclusion, që do të zbatohet në bashkëpunim me Shoqatën MEDPAK dhe Komunën e Barit në Itali për një periudhë 2 vjecare, financuar nga Programi IADSA. Qëllimi i projektit është përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet aspektit artistik dhe përshtatjes së infrastrukturës së objekteve publike të qytetit.

Detyra Specifike

- Financieri është përgjegjës për menaxhimin financiar dhe administrativ të aktiviteteve të projektit dhe i raporton në mënyrë të drejtpërdrejtë Menaxherit të Projektit;
- Kryen punë të përditshme në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative të kontratës të projektit;
- Ndhmon ekipin e projektit në të gjitha aktivitetet e projektit siç kërkohet nga menaxheri i projektit;
- Është përgjegjës për shpenzimet e realizuara dhe procesin e raportimit;
- Monitoron shpenzimet e realizuara nga partnerët për aktivitetet e realizuara;
- Merrret me procedurat e prokurimeve;
- Merr pjesë në mbledhjet e këshillave drejtuese dhe çdo mbledhje tjetër që kërkohet nga menaxheri i projektit;
- Monitoron shpenzimet mujore të projektit dhe bën propozime që kanë për qëllim përmirësimin e procesit të zbatimit financiar;
- Të hartojë raportin financiar të ndërmjetëm dhe final të projektit e projektit;
- Ka përgjegjësinë e përgjithshme për çështje administrative të një natyre më të përgjithshme, të tilla si mirëmbajtja e dosjeve të projektit dhe aseteve të projektit ;
- Përgatit transfertat, urdhërat e misionëve, fletë-pagesat dhe të gjitha dokumentet e tjera financiare siç kërkohet;
- Kryen të gjitha detyrat e tjera administrative dhe financiare të lidhura, me kërkesë të Menaxherit të Projektit.

Kualifikimet kryesore të kërkuara:

- Kandidati që kërkon të punësohet në rolin e Financierit të Projektit duhet të përmbushë këto kritere:
- Të ketë diplomë universitare në shkencë ekonomike.
- Të ketë 3-5 vjet eksperiencë pune;
- Të ketë eksperiencë pune me projektet e financuara nga BE apo nga donatorë të tjerë.



- Aftësi të shkëlqyera në komunikim dhe aftësi të provuara të punës në grup;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane;

Personi që dëshiron të aplikojë për këtë pozicion pune të dërgojë : një CV si dhe një letër interesi duke shprehur qartë se përse mendon se mund të jetë i përshtatshëm për këtë vend pune dhe se si i përmbush kërkesat, kualifikimet e kërkuara në adresën e emailit: bashkiapeqin@yahoo.com para orës 16:00 deri në datë 1.Gusht 2016.



BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin po kërkon të punësoj një Koordinator/e projekti

Bashkia Peqin në kuadër të projektit Mind the Gap- A model or Social Inclusion, që do të zbatohet në bashkëpunim me Shoqatën MEDPAK dhe Komunën e Barit në Itali për një periudhë 2 vjecare, financuar nga Programi IADSA. Qëllimi i projektit është përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet aspektit artistik dhe përshtatjes së infrastrukturës së objekteve publike të qytetit.

Detyrat specifike:

Detyrat specifike dhe përgjegjësitë e Koordinatorit/es të Projektit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:

- Do të jetë përgjegjës për mbarëvajtjen e aktiviteteve të projektit M-GAP që do zbatohet në Peqin.
- Do të mbulojë detyrimet e projektit si psh: raportim të aktiviteteve, raportet narrative të kërkuara nga donatori, timesheet etj.
- Do të jetë në komunikim të vazhdueshëm me ekipin e zbatimit të Projektit për të hartuar planet e aktiviteteve 4 mujore, 1 vjecare dhe të raportojë përpara donatorëve.
- Të jetë raportojë përpara Bashkisë për mbarëvajtjen e aktiviteteve .
- Të lehtësojë nga ana logjistike për secilin aktivitet,
- Të prezantojë projektin përpara palëve të treta me përgjegjësi dhe në përputhje me objektivat e tij..
- Të lehtësojë zbatimin e aktiviteteve të projekteve

Kualifikimet dhe kriteret që kërkohen për Koordinator/en :

- Diplomë në punë sociale, psikologji, juridik, ekonomik, shkenca politike minimumi të ketë diplomë të nivelit master, (pra 3+2).
- Të ketë përvojë pune të paktën 1-2 vjet në institucione publike ,private ose organizata.
- Eksperiencat e mëparshme të punës në projekte
- Të jetë në gjendje të punojë si në zyrë edhe në terren.
- Të ketë aftësi komunikuese të mira me stafin dhe persona të tretë.
- Të jetë korrekte dhe të respektojë afatet.
- Të ketë rrjedhshmëri në të shkruar dhe të folur të gjuhës shqipe, italiane dhe angleze;
- Aftësi në përdorimin e paketës Microsoft Office

Personi që dëshiron të aplikojë për këtë pozicion pune të dërgojë : një CV si dhe një letër interesi duke shprehur qartë se përse mendon se mund të jetë i përshtatshëm për këtë vend pune dhe se si i përmbush kërkesat,



kualifikimet e kërkuara në adresën e emailit: bashkiapeqin@yahoo.com para orës 16:00 deri në datë 1.Gusht 2016.

BASHKIA PEQIN

(Faint, illegible text, likely a list of requirements or conditions for the position.)



BASHKIA PEQIN

Bashkia Peqin po kërkon të punësoj një Specialist i Aftësisë së Kufizuar

Bashkia Peqin në kuadër të projektit Mind the Gap- A model or Social Inclusion, që do të zbatohet në bashkëpunim me Shoqatën MEDPAK dhe Komunën e Barit në Itali për një periudhë 2 vjecare, financuar nga Programi IADSA. Qëllimi i projektit është përfshirja sociale e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet aspektit artistik dhe përshtatjes së infrastrukturës së objekteve publike të qytetit.

Përmbajtja e përgjithshme e punës:

Specialist i Aftësisë së Kufizuar do të ofrojë suport për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në projekt duke u bazuar në legjislacionin kombëtar dhe në Konventën së OKB-së mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Detyrat specifike:

- Përgjegjës për sigurimin e mbështetjes së përgjithshme të projektit
- Realizon punën e përditshme në përputhje me planin e aktiviteteve.
- Asiston në menaxhimin e projektit: planifikimin, përgatitjen, rishikimet e ekzekutimit dhe aktivitetet, të bazuar në sfond gjithëpërfshirës.
- Asiston ekipin e projektit në të gjitha aktivitetet e projektit që lidhen me aspektin e aftësisë së kufizuar.
- Harton së bashku me ekipin progres raportet e projektit dhe siguron dorzimin në brënda afateve.
- Asiston ekipin e projektit në gjenerimin dhe shpërndarjen e informacionit të aktivitetet të projektit në mesin e aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Ndjek çështje e personelit për aktivitetet në ngarkim si psh mban të dhënat e pjesëmarrjes, raportet e pushimi, që do të dërgohen për menaxhimin e projektit.
- Asiston në të gjitha aranzhimet logjistike për realizimin e projektit.

Kualifikimet dhe aftësitë:

1. Diplomë universitare në shkencat sociale, juridike ose fusha të ngjashme;
2. Eksperiencia të mëparshme 1-2 vjet pune ne projekte kombëtare ose ndërkombëtare për aftësinë e kufizuar
3. Njohje e legjislacionit kombëtar dhe një ndërkombëtar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
4. I/E Vetë-motivuar dhe i/e disponueshme për të punuar nën presion;



5. Aftësi shumë të mira shkrimi të raporteve.
6. Aftësi të shkëlqyera në komunikim dhe aftësi të provuara të punës në grup;
7. Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe Italiane

Personi që dëshiron të aplikojë për këtë pozicion pune të dërgojë : një CV si dhe një letër interesi duke shprehur qartë se përse mendon se mund të jetë i përshtatshëm për këtë vend pune dhe se si i përmbush kërkesat, kualifikimet e kërkuara në adresën e emailit: bashkiapeqin@yahoo.com para orës 16:00 deri në datë 1.Gusht 2016.